



REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

**C.nr.967/12**

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**, si gjykate civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në çështjen juridike të paditësit I. T. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. O. R. nga Prizreni, kundër të paditurit F. G. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, përndryshe drejtor i firmës N.P "D. C.", me objekt të padisë kthimin e borxhit, vlera e kontestit 47.000 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në mungesë të pales së paditur, me datë **18.12.2013** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit I. T. nga Prizreni.

**II. DETYROHET** i padituri F. G. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, pronar i N.P "D. C." me seli në L. A., që paditësit t'ia kthej shumën e të hollave prej **47.000 €**, të paguara nga ana e paditësit me rastin e blerjes së banesës, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**III. DETYROHET** i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale, paditësit t'i paguaj shumën prej **316 €**, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të palës së paditur, në kuptim të nenit 423 paragraf 4 të LPK-së.

I autorizuari i paditësit av. O. R. gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë pohimeve të theksuara në padi dhe kërkesëpadi si dhe precizimit të bërë në shqyrtimin kryesor, duke cekur se i padituri i ka borxh paditësit shumën prej 47.000 €, në emër të shitëblerjes së banesës dhe atë në bazë të kontratës interne të lidhur me shkrim ndërmjet paditësit dhe të paditurit me datën 26.06.2009. Më tutje ka shtuar se objekt i kësaj kontrate ka qenë shitëblerja e banesës e cila ndodhet në kompleksin afarist banesor -2B+P+7 në ndërtesën K. .., në Bllokun ../ në sipërfaqe prej 96.20 m<sup>2</sup>, për çmimin prej 63.000 €. Për këtë paditësi ka paguar shumën e të hollave prej 18.000 € kesh nëpërmjet Bankës për Biznes në Prizren, ndërsa shumën prej 2000 €, paditësi i ka paguar të paditurit me rastin e arritjes së marrëveshjes në emër të kaparit, kurse paditësi i ka dhënë të paditurit një gjenerator të cilit i kanë caktuar vlerën prej 27.000 €, që do të thotë se paditësi i ka paguar të paditurit shumën e përgjithshme prej 47.000 €. Nga kjo shumë paditësi i ka mbetur pa paguar të

paditurit shumën prej 16.000 €, të cilat është dashur që të ja paguaj me datë 01.01.2011, me rastin e dorëzimit të banesës në pronësi të paditësit. Mirëpo deri më sot i padituri nuk e ka dorëzuar banesën në fjalë, sepse ky nuk ka qenë pronar legjitim i kësaj banese, por një person tjetër, kështu që paditësi është mashtruar nga i padituri, duke u paraqitur si pronar i banesës. Më tutje ka shtuar se gjeneratori ende gjendet në shfrytëzim të të paditurit të cilin tani për shkak të amortizimit paditësi nuk ka llogari që të kërkoj kthimin e tij. Në fund ka shtuar se pasi që nga provat të cilat janë deponuar në shkresat e lëndës, vërtetohet se borxhi egziston, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në shumën e përgjithshme prej 316 € dhe atë për dy përfaqësime në seanca gjyqësore nga 100 €, për përpilim të padisë 100 € dhe për taksë gjyqësore 16 €.

I padituri F. G. nuk ka parashtruar përgjigje në padi, si dhe nuk ka marr pjesë në shqyrtimin pregaditor dhe atë kryesor, edhe pse i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt, por mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), si dhe bindjes së lirë të saj, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar.**

Në këtë drejtim gjykata për vlerësimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: kontratën për shitëblerje e dt. 26.06.2009, fletëdeponimin e datës 26.06.2009, ka dëgjuar dëshmitarët N. S. dhe R. T.

Nga kontrata e lidhur me shkrim të dates 26.06.2009, vërtetohet fakti se paditësi I. T. ka blerë një banesë nga i padituri F. G. në vlerë prej 63.000 €. Banesa ndodhet në Kompleksin afarist banesor -2B+P+7, në ndërtesën K. ..., në bllokun ../.. në Prizren, me një sipërfaqe prej 96.20 m<sup>2</sup>. Më tutje në nenin 3 të kësaj kontrate është konstatuar se paditësi i paguan si kapar të paditurit shumën prej 2.000 € dhe shumën të të hollave prej 18.000 € kesh në mes të bankës BpB në Prizren ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, si dhe pajtimin e këtu palëve ndërgjyqëse që paditësi t'i jep një gjenerator të paditurit në vlerë prej 27.000 €, që do të thotë se paditësi si blerës i'a ka paguar gjithsejt 47.000 € të paditurit në emër të blerjes së kësaj banese. Kurse sipas nenit 5 të kësaj kontrate shumën prej 16.000 € paditësi ka ngelur që t'ia paguaj të paditurit me datën 01.01.2011, me rastin e dorëzimit të banesës në pronësi të paditësit. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi faktin se i padituri deri më sot nuk e ka dorëzuar banesën në posedim dhe shfrytëzim tek paditësi, pasi që i njëjti nuk ka qenë pronar legjitim i kësaj banese.

Edhe dëshmitari N. S. gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin kryesor, ka vërtetuar faktin se paditësi dhe i padituri kanë lidhur kontratën për shitëblerjen e banesës në zyrën e të paditurit N.P "D. C." në prezencën e dëshmitarit R. T. Dëshmitari deklaroi se me rastin e lidhjes së kontratës R. i ka dhënë kapar të paditurit 2.000 € në emër të I. T., po ashtu janë marë vesh që paditësi si blerës të jep një gjenerator në vlerë prej 27.000 €, i cili i është dhënë në posedim menjëherë të paditurit të cilin ende e ka në shfrytëzim dhe një pjesë tjetër të parave paditësi t'ia dorëzoi nëpërmjet bankës.

Poashtu dëshmitari R. T. gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor vërtetoi faktin se paditësi me të paditurin kanë arritur marrëveshje për shitëblerjen e banesë e cila gjendet tek kompleksi banesor K. afër "B.", në katin e .. në bllokun .., në sipërfaqe prej 96 m<sup>2</sup> në shumën prej 63.000 €. I njëjti deklaroi se paditësi me rastin e lidhjes së kontratës të paditurit i ka dhënë 2.000 € si kapar dhe një gjenerator i cili ka kushtuar 27.000 €, i cili ende është në shfrytëzim të të paditurit, ndërsa pjesa tjetër prej 18.000 € është dashur ti jepet nëpërmjet të bankës, kurse të gjitha këto veprime janë kryer në prani të dëshmitarit N. S. dhe babait të të paditurit.

Nga fletëdeponimi i datës 26.06.2009, i lëshuar nga Banka për Biznes Dega në Prizren, vërtetohet fakti se paditësi i ka paguar të paditurit shumën prej 18.000 €, në emër të blerjes së banesës.

Nga të lartcekurat, gjykatës i rezultoi se i padituri i ka borxh paditësit shumën e cekur në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, fakt ky që u vërtetua nga kontrata dhe fletëdeponimi i datës 26.06.2009, si dhe nga dëshmia e dëshmitarëve të lartëcekur, të cilave dëshmi gjykata ja fali besimin e plotë, pasi që të njëjtat ishin në përputhje me njëra tjetrën, si dhe për faktin se i padituri përkundër mundësisë që ja ka dhënë gjykata që t'i kundërshtojë pretendimet e paditësit, i njëjti këtë gjë nuk e ka bërë, pasi siç e cekëm më lartë, i njëjti nuk ka parashtruar përgjegje në padi (nuk ka ofruar prova materiale që do të vërtetonin të kundërtën) dhe nuk ma karr pjesë në shqyrtimet e mbajtura edhe pse ka qenë i thirrur me rregull.

Në këtë drejtim neni 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) parasheh që *"pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij"*, kurse në nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *"kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësishtë sikundër është përmbajtja e tij"*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në zbatim të nenit 452.1 të LPK-së dhe TA-së, ku është obliguar i padituri që paditësit ti paguaj shumën e përgjithshme prej 316 € dhe atë për dy përfaqësime në seanca gjyqësore nga 100 €, për përpilim të padisë 100 € dhe për taksë gjyqësore 16 €.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 17, 262, lidhur me nenin 143 të LPK-se, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**C.nr.967/12, datë 18.12.2013**

**Procesmbajtësja,**  
**Raxhije Emiri**

**Gjyqtari,**  
**Lumni Sallauka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.